



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 9, datë 12.1.2016

PËR

**MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS
SË ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT TË QARKUT
TË KORÇËS**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjës “gj”, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Struktura e administratës së prefektit të qarkut të Korçës të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e administratës së prefektit të qarkut të Korçës të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të administratës së prefektit të qarkut të Korçës të jetë, gjithsej, 29 veta.
4. Urdhri nr.86, datë 21.2.2014, i Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së prefektit të qarkut të Korçës”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

STRUKTURA E ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT TË QARKUT TË KORÇËS

